



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.11.2020, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Ardiana Jaku, Almira Xhembulla, Majlinda Halilaj, Florenc Spaho, Eugen Bojaxhiu, Amra Barova, Koçi Tahiri, Edmond Stojku, Halil Jakimi, Ervis Meço, Rolant Xhelilaj dhe Klotilda Bushka.

Mungojnë:

Të ftuar:

Bardhylka Kospiri – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Geraldina Prodani – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Merita Xhafaj – Drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me këtë rend dite: shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Komisioni ynë e shqyrton nismën e Këshillit të Ministrave në cilësinë e komisionit përgjegjës. Sot do të zhvillojmë diskutimin në parim të projektligjit.

Të ftuar në këtë mbledhje nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kemi zonjën Bardhylka Kospiri, zëvendësministre, zonjën Geraldina Prodani, sekretare e Përgjithshme, dhe zonjë Marita Xhafaj, drejtore e Përgjithshme.

Fjala e ka zëvendësministrja, për të na bërë një prezantim të projektligjit.

Bardhylka Kospiri – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale vjen në komision me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””. Qëllimi i projektligjit është miratimi i shtesave dhe ndryshimeve në ligjin ekzistues.

Objekti i këtij projektligji është garantimi i një cilësie më të mirë të shërbimeve në fushën e punës sociale, sidomos në atë të shërbimeve sociale.

Projektligji përmban 6 nene dhe propozon ndryshime dhe shtesa në ligjin ekzistues për të rregulluar më mirë profesionin e punonjësit social, duke arritur një përputhshmëri të plotë edhe me ligjet që rregullojnë profesionet e tjera, si ai i psikologut.

Gjatë zbatimit në praktikë të ligjit nr. 163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, ka dalë në pah problemi i nevojës për shprehjen në mënyrë të qartë të kriterëve të diplomimit për punonjës social dhe dispozitave për rregullimin e licencimit të punonjësve socialë, që tashmë e ushtrojnë këtë profesion, por nuk plotësojnë kriterin e diplomimit, që krijon një situatë të pafavorshme për këta të fundit dhe cenon cilësinë e ofrimit të shërbimit nga persona profesionistë.

Arsyet e ndërmarrjes së këtyre ndryshimeve janë:

Së pari, rregullimi i procesit të anëtarësimit të punonjësve socialë në Urdhrin e Punonjësit Social. Për këtë propozohet riformulimi i kriterit të diplomimit. Unë nuk po e lexoj, sepse ju i keni materialet përpara, por duke propozuar riformulimin e kriterit të diplomimit,

pritet të rritet cilësia e ofrimit të shërbimeve në fushën e punës sociale, sidomos në atë të shërbimeve sociale, pasi do të ofrohet nga persona të diplomuar dhe kualifikuar për to.

Së dyti, ka të bëjë me sigurimin e një përfaqësimi më cilësor në Këshillin Kombëtar të Urdhrit të Punonjësit Social, duke shtuar kritere të reja për personat që kandidojnë për këtë anëtarësi. Ligji ekzistues për Urdhrin e Punonjësve Social, parashikon në nenin 13 të tij funksionet e Këshillit Kombëtar të Urdhrit, i cili, si organ ekzekutiv, ndër të tjera, ka dy funksione tejet të rëndësishme lidhur me ushtrimin e këtij profesioni:

Së pari, miraton Kodin Deontologjik të punonjësit social.

Së dyti, ngre grupe pune *ad hoc* për kryerjen e kontrolleve për ushtrimin e profesioneve të punonjësit social. Në këto kushte, është e nevojshme që anëtarët, të cilët vendosin për këto funksione duhet të jenë të përgatitur teorikisht, të kenë përvojë në zbatimin dhe problematikat e këtij profesioni, si dhe të mos kenë masa disiplinore. Me anë të këtij ndryshimi pritet që rritja e nivelit të përfaqësimit në këshill të sjellë ushtrim më të mirë të funksioneve të tij e, për rrjedhojë, të rrisë edhe nivelin e ofrimit të shërbimit publik me anë të kontrolleve të mirëmenaxhuara.

Së treti, rregullimi i procedurës kalimtare për personat që e ushtrojnë tashmë profesionin e punonjësit social, por që nuk përmbushin kriterin e zotërimit të diplomës së studimeve të larta “Bachelor” në punë sociale dhe “Master i Shkencave/Profesional” në fushën e punës sociale ose ekuivalente me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.

Me anë të nenit 5 të këtij projektligji, është riformuluar neni 19 i ligjit “Dispozitat kalimtare”, në mënyrë që individët, që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, e ushtrojnë ose kanë ushtruar profesionin e punonjësit social për një periudhë të caktuar kohe, por nuk kanë formimin dhe kualifikimin profesional minimal, sikurse kërkohet nga ndryshimet e ligjit, do ta ruajnë vendin e punës për një afat të caktuar por do të jenë të detyruar të ndjekin programe të formimit dhe kualifikimit profesional. Pas përfundimit të programimit të formimit dhe kualifikimit profesional, të përshtatshëm për ushtrimin e profesionit të tyre, ata i nënshtrohen provimit të shtetit. Kjo kategori është e nevojshme që të fitojë dhe të zhvillojë aftësi për të aplikuar koncepte dhe strategji të kërkimit shkencor në praktikën e punës sociale, si dhe të marrë njohuri të thelluara profesionale për të adresuar dhe referuar problemet shëndetësore e ato psikosociale të personave që e marrin shërbimin. Ndërkohë, profesionisti, i cili ka kualifikimin minimal sipas kriterëve të ndryshimeve të këtij ligji, regjistrohet pranë Urdhrit profesional.

Projektligji nuk ka efekte financiare... *(Nuk dëgjohet)*

Enver Roshi – Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Natyrisht ky projektligj është një hap para i ligjit të tanishëm që ka qenë për punonjësit socialë. Dua të them se ka shumë vende pune në të gjithë strukturën e bashkive, ministrive dhe të tjerave në Shqipëri, që mbulohen nga shumë profesione të tjera dhe se me këtë ligj besoj se do të rritet edhe cilësia e punës edhe në ndihmë të shumë shtresave që janë në nevojë dhe që kanë nevojë për punonjës socialë. Natyrisht, ky ligj kërkon debate, kërkon ekspertizë dhe unë po ia kaloj fjalë deputetes Ardiana Jaku si racatore për të prezantimin ligjit.

Fjala për ju Ardiana.

Ardiana Jaku – Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje të gjithë kolegëve dhe përfaqësuesve të ministrisë, si dhe mësuese Tinës që na është bashkuar sot!

Unë jam e gëzuar që më në fund ne ia dolëm të kemi projektligjin e përfunduar. Unë mbaj mend se ky proces ka nisur që në vitin 2018 në ministri, ku është diskutuar gjatë se si profesioni i punonjësit social të ishte një profesion i rregulluar si të gjitha profesionet e tjera. Pavarësisht se ligji për ngritjen e Urdhrit të Punonjësit Social është hartuar që në vitin 2014, në fakt, anëtarësimet për këtë urdhër janë kryer, mesa kam informacion, edhe nga profesionistët e fushës, akademikët e kësaj fushe për efekt të disa mospërputhjeve që kishte ligji i vitit 2014. Sot jemi në fazën kur diskutojmë këtë projektligj të hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, i cili sillet për diskutim këtu në komisionin tonë dhe më pas edhe në parlament.

Synimi kryesor i këtij ligji është që shërbimet sociale të ofrohen në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të ofrohen me një standard të lartë. Këtë e siguron fakti që profesionistët e kësaj fushe që janë të mirëkualifikuar, të përfaqësuar në një Urdhër dhe patjetër të kalojnë të gjitha hallkat e kualifikimeve pse jo edhe edukimin në vazhdim. Ashtu sikurse edhe zëvendësministrja e përmendi më në detaje, të nderuar kolegë, tri objektivat kryesore që na paraqet ky projektligj janë:

1. Rregullimi i procesit të anëtarësimit të punonjësve socialë në Urdhrin e Punonjësit Social.

2. Sigurimi i një përfaqësimi më cilësor në Këshillin Kombëtar të Urdhrit, të punonjësit social. Këto ndryshime janë bërë për faktin e rritjes së nivelit të përfaqësimit në rritja këtë Këshill.

3. Gjithashtu edhe një handicap që kishte ligji i mëparshëm dhe që rregullohet me këtë ligj është se procedura kalimtare për personat që e ushtrojnë tashmë profesionin e punonjësit social, siç kryetari e përmendim, por që nuk përmbushin kriterin e zotërimit të diplomës së

studimeve të larta “Bachelor” në punë sociale dhe “Master i Shkencave/Profesional” në fushën e punës sociale.

Unë besoj se ky ligj do t’i hapë rrugë ndërtimit të këtij Urdhri. Sikurse të gjitha profesionet e tjera janë të rregulluara me një urdhër, të gjithë profesionistët duhet të kalojnë në filtrin e këtij urdhri.

Siç e përmenda, i gjithë fokusi dhe qëllimi i ngritjes së këtij Urdhri është krijimi dhe ofrimi i shërbimeve shoqërore sa më cilësore për qytetarët. Kjo vjen edhe në plotësim të kuadrit ligjor nr. 121 “Për shërbimet ligjore”, i cili i vë një theks shumë të rëndësishëm profesionistëve të ofrimit të këtyre shërbimeve, por, së pari, bëhet për të mbrojtur vetë profesionistët, që të kenë një urdhër, të ndihen të mbrojtur dhe të kualifikohen në vijimësi.

Unë ftoj të gjithë anëtarët e komisionit ta miratojmë sot në parim!

Besoj se më pas do ta kalojmë nen për nen, për të kuptuar më konkretisht ndryshimet e bëra dhe të përcjella përmes këtij projektligji.

Faleminderit, kryetar!

Enver Roshi – Faleminderit, relatore!

Siç e tha zonja Adriana, ky ligj disiplinon të gjithë profesionin e Urdhrit të Punonjësit Social. Po ashtu, kërkon të disiplinojë të gjitha vendet e punës të profesionistëve të tjerë, duke u dhënë afat atyre që janë jashtë profesionit, në një periudhë kohe të shkurtër, rreth 5 vjet, të mbarojnë Master Profesional ose Shkencor pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, dhe t’i nënshtrohen provimit përfundimtar të licencës, me qëllim që në të gjithë vendin të punohet me një metodologji dhe të rritet cilësia e shërbimit.

Naturshëm që tregu i punës është i hapur, por edhe i kontrolluar nga Urdhri i Profesionistit, që ne vazhdimisht në administratë të sjellim njerëz me përvojë, me eksperiencë, me edukim të profilizuar për këto profesione, sepse njerëzit kanë nevojë për shërbim cilësor dhe profesional, për profesionistë të edukimit përkatës, jo me diploma apo kurse të shkurtra, por vetëm me shkollë të njohur dhe të akredituar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Mendoj se ky ligj do të sjellë risi dhe, njëkohësisht, ftoj Ministrinë e Shëndetësisë të punojë për Urdhrin e Profesionistit të Shëndetit Publik në Shqipëri, sepse në shumë profesione duhet të punojnë ata që mbarojnë shëndetin publik, pra të disiplinohet urdhri i profesionistit të shëndetit publik.

A ka diskutime të tjera nga kolegët?

Profesoreshë Eglantina, ju falënderoj që jeni në komisionin tonë!

Ju jeni kryetare e Komisionit për Barazinë Gjinore dhe është kënaqësi t’ju kemi në komision!

Do të donim të dinim mendimin tuaj, sepse jeni shtysë e këtij projektligji, për ta aprovuar në parlament.

Fjala për ju.

Eglantina Gjermeni - Faleminderit, kryetar!

I falënderoj kolegët!

Unë e kam ndjekur këtë projektligj që në momentin kur qeveria ka filluar hartimin e këtij Urdhri, pasi ata janë nismëtarët dhe të angazhuarit për kontributin kryesor të tij.

Unë i falënderoj shumë për të gjithë procesin që kanë realizuar dhe për nismën!

Siç u tha nga zëvendësministrja dhe relatorja, ky projektligj është shumë i rëndësishëm. Qëllimi kryesor është të rrisë cilësinë e shërbimeve sociale, të përmirësojë standardet e tyre dhe të kristalizojë një profesion, që është relativisht i ri në Shqipëri në krahasim me profesionet e tjera.

Mendoj se, sidomos tani, në kushtet kur nga Ministria e Arsimit janë hapur shumë vende pune për punonjës socialë dhe për psikologë në shkolla, duke vlerësuar së tepërmi rolin dhe kontributin që mund të luajnë këto profesione në parandalimin e problematikave, çështjeve sociale për parandalimin e problematikave me të cilat përballen fëmijët dhe adoleshentët dhe në adresimin e tyre, si dhe një sërë fushash të tjera të shërbimeve sociale apo të politikëbërjes në Shqipëri. E konsideroj si një projektligj shumë të rëndësishëm, i cili ka ardhur në momentin e duhur dhe që do të impakt në cilësinë e shërbimeve që do të ofrohen në Shqipëri.

Po ashtu, dua të theksoj faktin, se duke qenë se ky proces, me aq sa di unë dhe përfaqësuesit e ministrisë besoj se më kuptojnë, ka qenë relativisht i gjatë, qoftë me diskutime me grupet e interesit apo qoftë me Ministrinë e Arsimit deri sa projektligji u arrit në këtë formë. Nuk e di nëse ju keni parashikuar një seancë dëgjimore me Urdhrin e Punonjësit Social, Departamentin e Punëve Sociale në Fakultetin e Shkencave Sociale apo edhe me punonjës socialë?

Enver Roshi – Kemi një plan për të bërë një diskutim me grupet e interesit.

Eglantina Gjermeni – Unë mendoj se gjatë gjithë këtyre viteve ky profesion është rritur dhe punonjësit e punëve sociale kanë përfituar një përvojë goxha të mirë, duke qenë në kontakt edhe me shoqatat e punonjësve socialë kudo në botë, sidomos në rajon, por edhe më gjerë me anë të projekteve rajonale dhe ndërkombëtare pikërisht për ta forcuar këtë profesion.

Po ashtu, mendoj se Urdhri luan një rol të rëndësishëm për promovimin e punonjësit social, në cilësinë e shërbimeve, por edhe për të parandaluar problemet e ndryshme të sjelljeve joetike dhe joprofesionale të këtyre profesionistëve. Me anë të seancës dëgjimore besoj se do të dalë më në pah arritja e cilësisë, ndërkohë edhe penalizimi i atyre që nuk i plotësojnë

standardet e këtyre shërbimeve, sepse do të diskutohen mendimet dhe sugjerimet e të gjitha grupeve që ju përmenda, por edhe të grupeve të tjerë që nuk janë parashikuar.

Ju falënderoj ju, përfaqësuesit e ministrisë, por edhe relatoren, zonjën Jaku, për angazhimin dhe uroj që projektligji që po diskutohet dhe që do të miratohet nga komisioni të përmbushë cilësinë, standardet dhe pritshmëritë e grupeve të interesit!

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, zonja Gjermani për mendimet dhe idetë e vyera dhe shtysën që i jepni këtij projektligji për të gjithë profesionistët e punës sociale në Shqipëri!

Kontributi juaj është i jashtëzakonshëm.

Fjalën e ka zoti Xhelilaj.

Roland Xhelilaj – Në fakt, nga shpjegimet e zëvendësministres, zonjës Gjermani dhe të relatores, na krijohen ide më të qarta.

Dua të di nëse ndërhyrjet që po bëjmë në ligj për punonjësit socialë a e realizojnë këtë objektiv kaq të rëndësishëm? Kjo pyetje është për zëvendësministren, për zonjën Gjermani dhe zonjën Jaku.

Punonjësi social ekziston, ndërsa ne synojmë ta ngremë në një nivel më të lartë. Në nivelin që ne pretendojmë të ngremë, ndërhyrjet që po bëhen në ligj, a e realizojnë këtë?

Në ligj theksohet se brenda një periudhë kohe të caktuar duhet të ketë realizuar Bachelorin apo edhe masterin shkencor dhe atë profesional, gjë, që është normale dhe e detyruar, pra nuk përbën ndonjë lloj kërkesë që del jashtë realitetit.

Gjithashtu, në projektligj thuhet se nuk ka efekte financiare. Pra, e gjithë kjo ndërhyrje dhe ngritja e nivelit çfarë efekti do të ketë? Unë mendoj se patjetër duhet të ketë edhe vlerësim.

Nuk diskutohet që ndërhyrja është shumë e mirë, sepse koha ka vërtetuar që punonjësit socialë janë mjaft të rëndësishëm në të gjithë aktivitetin social-ekonomik kudo ku ai e ushtron profesionin e tij. Problemi qëndron në faktin se si do të ndikojmë ne te këta njerëz për ta kryer këtë detyrë, vetëm duke bërë një urdhër për punonjësit socialë si të gjithë urdhrat e tjerë të sektorëve përkatës apo do të kenë edhe stimulim dhe vlerësimin material më afër punës së bërë në qoftë se ka diferenca, të cilat në kohë kanë detyruar të kthejnë vëmendjen këtu. Janë disa lloj pikëpyetjesh, për të cilat mund të mos jem shumë korrekt me këtë që them, por mendoj se ia vlen të marrim një përgjigje sot, para se të bëjmë takimet me grupet e interesit.

Faleminderit, kryetar!

Enver Roshi – Faleminderit!

Po, zonja Bardhylka.

Bardhylka Kospiri – Përshëndetje!

Grupet e interesit na japin rekomandimet se si do të ishin detajuar hapat për zbatimin e këtij ligji, ngaqë shikonim vështirësi në zbatim. U rishikua edhe një herë në këtë kuadër bashkë me grupet e interesit. Kështu që, ligji që paraqitet sot ka vetëm përmirësime të bërë mbi bazën e ligjit ekzistues. Ligji ekzistues i ka parashikuar të gjitha këto, efektet financiare me shumë kujdes, sepse*(nuk kuptohet)* ...ka buxhetin e tij, të cilin e harton dhe administron Këshilli Kombëtar bashkë me rregullat financiare të tij dhe rregulloren e brendshme të veprimtarinë financiare *(nuk kuptohet)*, sepse edhe anëtarësia ka detyrimet e veta.

Enver Roshi – Mezi dëgjoheni, zonja Kospiri.

Bardhylka Kospiri – Neni 10 i ligjit ekzistues, që parashikon edhe efektet financiare i bie deri në 7 ditë. Pasi ngrihet Urdhri i Punonjës Social, urdhri ka buxhetin e tij dhe mbulimet financiare bëhen nëpërmjet buxhetit....*(nuk kuptohet)*,

Ndërkohë, përbërja e buxhetit është nga ... e anëtarëve, ajo ka vendosur për aktet e lëshuara nga urdhri, sanksione të ndryshme dhe të ardhura të tjera.

Të ardhurat e siguruara urdhri i përdor të përmbushur synimet dhe objektivat e tij.

Enver Roshi - Faleminderit!

Jeni dakord, zoti Xhelilaj?

Roland Xhelilaj – Nuk jam dakord plotësisht, megjithatë kjo ia vlen për t'u hulumtuar, se pastaj duhet të themi: po deri sot si është paguar punonjësi social? Si është diferenca e tij me profesionet e tjera, të cilat kryejnë përafërsisht të njëjtën gjë, funksionojnë në të njëjtin drejtim? Çfarë sjell ky urdhër dhe çfarë u siguron punonjësve socialë dhe sa e forcon pozicionin e tij?

Megjithatë, me kuotizacionet është gjë që është normale, nuk ka lidhje fare me buxhetin. E kam për mënyrën e funksionimit sot dhe si do të funksionojë pasi ky urdhër të krijohet. Çfarë trysnie ju sjell atyre?

Enver Roshi – Klodi, fjala për ju.

Klodiana Spahiu – Përshëndetje të gjithëve!

Në fakt, mendoj se në vitin 2014, kur ne kemi bërë një unifikim të të gjithë urdhrave, ka qenë një hap shumë pozitiv dhe në atë moment nuk ka qenë shumë e thjeshtë të ndiqnim të njëjtën skemë, siç ishte rasti i infermierëve dhe i mjekëve për të qenë profesion i rregulluar, me punonjës social dhe me psikologun dhe arsyeja ishte që një pjesë e mirë e të punësuarve si punonjës social mund të kishin bachelorin jo për punonjës social, por mund të kishin masterin si punonjës social. Tani kanë kaluar 6 vjet. Në momentin që ne kemi kaluar ligjin nuk mundeshim që të sakrifikonim një numër të caktuar punonjësish me një eksperiencë shumë të mirë në fushën e tyre, ndaj i kemi lënë një kohë të caktuar dhe në atë kohë vendimi nuk ka qenë shumë i thjeshtë për të vendosur që nga ai moment nuk do të pranohet si punonjës socialë ata

që kanë mbaruar masterin apo bachelorin në një degë tjetër. Ka qenë një vendim i konsultuar. Kemi diskutuar shumë gjatë me grupet e interesit, dhe është rënë dakord që këto 6 vjet që kanë kaluar t'iu jepet mundësia. Pra, nuk është një gjë që e dëgjojmë për herë të parë, por përkundrazi unë mendoj se ka pasur kohë më tepër se duhej. Pra në 6 vjet të gjithë punonjësit socialë që nuk kanë pasur një formim qoftë në bachelor, qoftë në master të punonjësit social e kanë pasur kohën e mjaftueshme. Tani ne duhet të biem të gjithë dakord që një punonjës social, për të gjitha arsyet që përmendi kolegja Gjermani, duhet të jetë në nivelin më të lartë të mundshëm. Për të qene në këtë nivel duhet që formimi në të dyja shkallët universitare të jetë i punonjësit social. Është i llogaritur numri i studentëve që dalin çdo vit me të dy diplomat. Qëllimi nuk është të heqim nga puna ato që kanë, sepse mund të kenë edhe eksperiencën e punës, por, ndërkohë unë insisto që e kanë pasur kohën e nevojshme për të arritur këtë ndryshim të njërit prej niveleve, të masterit ose bachelorit. Unë mendoj se për kolegët që janë të rinj në komision ne duhet ta çojmë përpara këtë gjë për të pasur një nivel sa më të lartë të këtyre profesionistëve siç janë të gjitha profesionet e tjera të rregulluara.

Faleminderit!

Enver Roshi – Unë dua të theksoj se edhe në ligjin ekzistues ka trajnime afatshkurtra, ndërsa projektligji e disiplinon më mirë dhe e ngre në një shkallë më të lartë kualifikimin e tyre pa përjashtuar profesionistët që tashmë janë në punë. Provimi i licencës është ai që i jep të drejtën e profesionit në vijim në të ardhmen.

A ka mendime të tjera?

Unë mendoj ta kalojmë në votim dhe të përcaktojmë ditën e premtë seancë dëgjimore me grupet e interesit.

Po, zonja Eglantina.

Kjo është një çështje që është diskutuar edhe në vitin 2014 dhe ka pasur interes. Nuk u ariut atëherë por tani kanë kaluar vite dhe duhet ky projektligj të vendosë këtë standard.

Pyetja ime është: çfarë ndryshimesh ka ky projektligj në krahasim me ligjin e kaluar për psikologun? Unë besoj se janë problematika të ngjashme, por dua të di sa nga nenet e këtij projektligji që ne diskutojmë sot kanë ngjashmëri, ose ndryshime? A janë përdorur të njëjtat standarde ose të ndryshme në lidhje me urdhrin e psikologut, sidomos kur bëhet fjalë për dispozita kalimtare.

Faleminderit!

Enver Roshi- Zonja Bardhylka.

Bardhylka Kospiri – Mirdita!

Faleminderit, zoti kryetar!

Në përgjigje të pyetjes së zonjës Gjermani unë do të doja të sqaroja pak situatën. Në fakt, ne jemi koshientë që këtë ligj e kemi miratuar për profesionet e rregulluara, i cili është propozuar dhe ndiqet zbatimi tij nga Ministria e Arsimit. Mbi bazën e këtij ligji janë hartuar të gjitha urdhrat e profesionistëve, përfshirë këtu edhe Urdhrin për Psikologun dhe Urdhrin për Punonjës Social.

Duhet t'i hyjmë pak historikut, sepse zonja Gjermani e di shumë mirë historikun, prandaj e përmblodhi, se këmbëngulja jonë ka qenë e jashtëzakonshme, sepse nga viti 2014 deri në vitin 2020 janë 6 vjet. Për 6 vjet ne jemi përballur me një debat dhe me një polemikë të pajustificueshme me të gjitha grupet e interesit. Natyrisht është e pamundur të kënaqen të gjitha dëshirat dhe interesat, por ne jemi të ndërgjegjshëm që kemi bërë më të mirën e mundshme që ky ligj të përputhet me ligjin “Për profesionet e rregulluara”, i cili ka ardhur sot në standardet ndërkombëtare dhe shpreh gjithmonë standardin bazuar në direktivat e BE-së. Për këtë arsye ka një diferencë, që është diferenca ndërmjet ngritjes së Urdhrit të Psikologut dhe Urdhrit të Punonjës Social. Ndryshimet që bëhen dhe që miratohen sot janë që punonjësit socialë nuk do të kalojnë në provim për të qenë pjesë e Urdhrit të Punonjës Social për shkak se këtu janë marrë në konsideratë të gjitha grupet e interesit që të kenë master në fushën respektive të shkencave sociale, po ashtu master profesional dhe *bachelor* në fushën e shkencave sociale si punonjës social. Për këtë arsye nuk është parë e arsyeshme diferenca nga Urdhri i Psikologut që këto të kalojnë në provim. Të gjitha pjesët e tjera janë të njëjta, qoftë mënyra se si do të ngrihet urdhri pa kaluar në provim, apo se si do të ngrihet dhe do të funksionojë Këshilli Kombëtar i Urdhrit, apo dhe buxheti, i cili është parashikuar në nenin 10 të ligjit ekzistues, sikurse është edhe te ligji “Për Urdhrin e Psikologut”.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, Merita!

Unë mendoj se veç profesionit të punonjës social, të psikologut, janë edhe profesione të tjera të shëndetit publik, pra janë disa vende pune në sistemin shëndetësor dhe jashtë tij që zihen nga profesione të tjera, se mendoj që këto profesione, që tashmë janë krijuar, duhet të profesionalizohen dhe kualifikohen më tutje për një standard më të lartë për profesionalizëm dhe cilësi më të mirë të shërbimeve. Natyrisht që ky ligj hedh hapa të mëtejshëm, sidomos në drejtim të edukimit akademik të tyre, të një diplome me qasje më të arrirë, jo me trajnime të shkurtra, të cilat jo se janë të parëndësishme, por kanë të bëjnë me edukimin në vazhdim të Urdhrit të Punonjës Social që është pjesë e ligjit. Në ligj është edhe edukimi profesional i tyre në të ardhmen, që quhet edukim në vazhdim.

Nëse nuk ka komente të tjera mendoj ta hedhim në votim në parim pastaj ditën e premte të lëmë një takim me grupet e interesit.

Atëherë, a jeni dakord? Ka kundër, apo abstenime në lidhje me projektligjin? Nuk ka.

Atëherë kalon në parim projektligji “Për punonjësit social”.

Falënderoj përfaqësuesit nga Ministria e Shëndetësisë, zonjën Bardhylka, zonjën Merita, në mënyrë të veçantë falënderoj profesororeshë Eglantinën për pjesëmarrjen e saj në komision dhe të gjithë anëtarët e Komisionit të Shëndetësisë!

Ditën e premte mendoj që në orën 10:00 të lëmë një takim me grupet e interesit.

A jeni dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Dakord.

Atëherë në orën 10:00 ditën e premte me grupet e interesit për të diskutuar në lidhje me projektligjin.

Faleminderit dhe mirupafshim në takime të tjera!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Arben Kamami

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Joana Bitri